

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.H. nga fsh. ... Komuna e Mitrovicës, dhe V.H., gjithashtu nga fsh., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, për të akuzuarin M.H., ndërsa, për të akuzuarin V.H., për vepër penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPRK-së, duke vendosur për ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Mitrovicë, dhe mbrojtësit të akuzuarit M.H., av. Q.R., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore - DKR në Mitrovicë, PKR.nr.117/2008, të dt. 19.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datën 06.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore DKR në Mitrovicë, si dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit M.H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PKR.nr.117/2008, të dt. 19.07.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin PKR.nr.117/2008, të dt. 19.07.2018, e ka shpallur fajtor të akuzuarin M.H., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 4 (katër) vjet, nuk kryen vepër tjetër penale. Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit i është llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej 04.09.2008 deri me datën 17.09.2008.

Të akuzuarin M.H. e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, si dhe shumë prej 60 €, në emër të Fondit për Viktimat, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me aktgjykimin e ankimuar i akuzuari V.H., bazuar në dispozitat e nenit 364 par. 1 nën par. 3 të KPPK-së, është liruar nga akuza e prokurorisë për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPRK-së, me arsyetim se me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari V.H., ka kryer veprën penale që me aktakuzë i vihet në barrë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore – DKR në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penale dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.H., av. Q.R., për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit M.H., t'i shqiptojë dënim me kusht me afat më të shkurtë të verifikimit, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën nuk i njoftoi fare palët, pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, nuk ka shqiptuar dënim me burgim, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/I.nr.374/2018, të dt. 06.09.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Mitrovicë, të aprovohet, kurse, ajo e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet, si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e kësaj gjykate.

Prokuroria Themelore – DKR në Mitrovicë, përkitazi me këtë bazë ankimore, pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.12 të KPPK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin, gjegjësisht, me deklaratën e të akuzuarit M.H., me arsyetim se në dispozitiv konstatohet "... i pandehuri merr pushkën M48 nga oda në shtëpi...", ndërsa, në arsyetim

në pjesën ku paraqitet përmbajtja e deklaratës së të akuzuarit M.H., deklaratë kjo e marrë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.01.2018, në faqen 4 konstatohet "... pa mbërrir V., afër meje në pjesën e pronës tonë në tokën ku ka qenë e mbjellë me kallamboq, e kemi pasur edhe pushkën në arë. Atë pushkë e kemi mbajtur për dy arsye ... arsyeja e parë është për shkak se gjatë asaj kohe ka pasur shumë derra të egër dhe na e dëmtojshin kallamboqin dhe po ashtu ne kemi bërë roje për të mbjellë atë dhe pas roje ne e kemi lënë edhe pushkën aty ...", që do të thotë se përkitazi me dilemat kryesore në këtë çështje penale-juridike, se i akuzuari a e mori pushkën nga oda e shtëpisë apo pushka ishte në arë- parcelën e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, nuk ka arritur të japë arsyerat për faktet vendimtare, fakte këto nga të cilat do të vërtetohej se i akuzuari a e ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë, pra, i akuzuari M.H., gjegjësisht i akuzuari tjetër V.H., a e kreu veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së. Gjithashtu, pra, gjithherë sipas pretendimeve ankimore, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin, sidomos kur në dispozitiv në rendin e gjashtë theksohet "... ka shtënë pesë deri në gjashtë herë në ajër, për t'i frikësuar të dëmtuarit H.SH. dhe B..." kurse përkitazi për faktet dhe rrethanat në fjalë, në arsyetim në pikën e gjashtë, kur gjykata bënë vlerësimin e provave, konstaton se i falë besimin deklaratës së dëshmitarit I.B., i cili deklaroi se "... i pandehuri M., me pushkë ka shtënë njëherë në ajër dhe pastaj ka shtënë edhe dy here tjera... deklarata kjo e cila ka mbështetje edhe në raportin e vendit të ngjarjes, ku rezultoi se është gjetur një gëzhgjë në pjesë të mbeturinave të familjes së të pandehurit, gëzhgjë që ka rezultuar se ishte nga të shtënë e pushkës...". Po ashtu, në kundërshtim të drejtë për drejtë me dispozitivin është edhe pjesa tjetër e deklaratës së të akuzuarit M.H., e cila është dhënë edhe në shqyrtimin gjyqësor të dt. 13.01.2018, në faqen 4, ku konstatohet "... unë kam marrë pushkën nga toka dhe kam shtënë në ajër dy apo tri herë, nuk jam i sigurte...". Prandaj, sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kur nuk ua ka falë besimin deklaratave të dëshmitarëve H.F., SH.F. dhe B.F., por edhe përkundër deklaratave në fjalë, të akuzuarin M.H. e ka shpallë fajtor për veprën penale me cilësim tjetër juridik e jo sikur që ka qenë i akuzuar me akuzën e prokurorisë, gjegjësisht të akuzuarin e dytë e ka liruar nga akuza për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, si për pjesën dënuese ashtu edhe për pjesën liruese.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara, ngase, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par.12 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, ku në dispozitiv janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, për të cilën edhe është shpallë fajtor i akuzuari, prandaj, sa i përket dispozitivit i njëjti nuk është në kundërshtim me arsyetimin por as me deklaratat e dëshmitarëve-të dëmtuarve e as të akuzuarit M.H., ngase, nga përmbajtja e deklaratave në fjalë, pa mëdyshje që rezultojnë të vërtetuara të gjitha faktet dhe rrethanat që edhe janë përshkruar në dispozitiv, ku pastaj, me të drejtë edhe ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, se bëhet fjalë për veprën penale mbajtja në pronësi, mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, pra, me cilësim tjetër juridik të veprës penale e jo sikur që ka qenë i akuzuar me aktakuzë i akuzuari M.H., për veprën penale vrasje

në tentativë nga neni 146 e lidhur me nenin 20 të KPK-së. Po ashtu, po përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet dhe rrethanat vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke përfshirë si ato faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 të KPRK-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesash i merr i të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra, janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë, edhe deklaratat e të dëmtuarve të dhëna në fazat e mëhershme të procedurës në këtë çështje penale-juridike, por që duke u bazuar me provat materiale në shkresat e lëndë, pastaj, kontradiktat në deklaratat e të dëmtuarve e të krahasuara me mbrojtjen e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, ua ka falë besimin deklaratave të dëmtuarve të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pra, ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Prandaj, përveç që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i pa qartësuar ose i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale e po ashtu e njëjta kur ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentativë në veprën penale mbajtja në pronësi, mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, përveç mbrojtjes së të akuzuarit M.H., i cili nuk i ka kontestuar faktet dhe rrethanat e përshkruara më detajisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, gjegjësisht faktet dhe rrethanat përkitazi me mënyrën e kryerjes së veprës penale, duke deklaruar se pasi ka eskaluar situata në mes tij dhe të dëmtuarve, atëherë me qëllim të frikësimit të dëmtuarve e ka marrë pushkën nga parcela e tij, ku e kishte lënë më parë dhe ka shtënë disa herë në ajër, për çka, pastaj, të dëmtuarit janë larguar nga vendi i ngjarjes, fakte këto dhe rrethana që i kanë vërtetuar edhe të dëmtuarit, të cilët, natyrisht me disa ndryshime në krahasim me deklaratat e dhëna në fazat e mëhershme të procedurës në këtë çështje penale-juridike, por që gjykata e shkallës së parë, duke i krahasuar të njëjtat me provat materiale në shkresa të lëndës, por edhe deklaratën e të akuzuarit M.H., e duke marrë parasysh distancën nga ku është shtënë nga i akuzuari, e faktin se asnjë nga të dëmtuarit nuk i ka qëlluar, e me këtë as shkaktimin e lëndimeve trupore, atëherë, gjykata e shkallës së parë, natyrisht duke ua falë besimin deklaratave të dëmtuarve të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, me të drejtë ka përfunduar se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për vrasje në tentativë por për vepër tjetër penale pra, mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, konkludime këto të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, edhe përkitazi me pjesën liruese edhe pse në ankesë nuk thuhet asnjë fjalë e vetme përkitazi me këtë bazë ankimore, kjo gjykatë vlerëson se edhe përkitazi me pjesën liruese gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe atë duke u bazuar, përveç në deklaratën e të akuzuarve edhe në deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, por, duke marrë parasysh edhe faktin se për të akuzuarin e parë gjykata ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vrasje në tentativë në armëmbajtje, atëherë, logjikisht për të akuzuarin e dytë nuk mund të ekzistojë vepra penale ndihmë në vrasje në tentativë, prandaj, edhe në këtë drejtim konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, janë të drejta, të ligjshme dhe se nuk qëndron pretendimi ankimor se e njëjta ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur e ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vrasje në tentativë në vepër penale të armëmbajtjes, për të akuzuarit M.H., gjegjësisht, kur e ka liruar të akuzuarin V.H., nga akuza e prokurorisë për vepër penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPRK-së.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, sidomos kur nuk janë marrë parasysh fare deklaratat e të dëmtuarve H.F., SH.F. dhe B.F., deklarata këto nga të cilat vërtetohen faktet dhe rrethanat se i akuzuari M.H., pasi më parë ka marrë armën nga i akuzuari tjetër V.H., dhe me të njëjtën pastaj ka shtënë në drejtim të dëmtuarve, fakte këto dhe rrethana nga të cilat rezulton se i akuzuari M.H., ka kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, ndërsa, i akuzuari V.H., veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPRK-së, për çka, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kur për të akuzuarin e parë e ricilëson veprën penale të vrasjes në tentativë në veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, ndërsa, të akuzuarin e dytë e liron nga akuza e prokurorisë për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penale-juridike gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar ka vërtetuar se i akuzuari M.H., pas një zënke me të dëmtuarit, për një moment kalon në anën e kundërt të rrugës, pra, në pronën e tij dhe pasi të dëmtuarit ishin menjëherë pas tij, kur vëren njërin nga të dëmtuarit që në dorë po e mbante një dru, i akuzuari M.H., e merr armën e tij të zjarrit - pushkën M48 dhe një distancë prej përafërsisht 100 m. larg nga të dëmtuarit ka shtënë disa herë, ku pastaj, të dëmtuarit janë larguar nga vendi i ngjarjes, fakte këto dhe rrethana që përveç që i akuzuari nuk i ka mohuar, janë vërtetuar edhe nga deklaratat e të dëmtuarve, por edhe dëshmitarit I.B., e që njëkohësisht të njëjtat kanë mbështetje edhe në provat materiale në shkresa të lëndës. Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese, se i akuzuari M.H., a ka shtënë me armën e tij me qëllim që t'i frikësojë të dëmtuarit apo këtë e bëri me qëllim që të dëmtuarit t'i privojë nga jeta, sikur që pretendohet me aktakuzë, gjykata e shkallës së parë, së pari ka marrë parasysh deklaratën e të akuzuarit M.H., i cili ka deklaruar se pas një grindje me të dëmtuarit, me qëllim të evitimit të konfliktit fizik me të dëmtuarit e kalon rrugën duke dalë në anën e kundërt në pronën e tij – parcelën, ku pasi vëren një nga të dëmtuarit se po mbante një dru në dorë, i akuzuari me armën e tij të cilën e kishte lënë më parë në parcelën ku kishte punuar dhe atë në distancë prej 100 m. larg nga të dëmtuarit me qëllim që t'i frikësojë të dëmtuarit, ka filluar të qëllonte në ajër, ku pastaj të dëmtuarit janë larguar nga vendi i ngjarjes, pastaj, deklaratat e vetë të dëmtuarve – të cilët deklarojnë se pasi e vërejnë të akuzuarin me armë në dorë menjëherë janë kthyer në drejtim të shtëpisë së tyre dhe kanë filluar të largohen nga vendi i ngjarjes, për çka, pastaj i akuzuari ka shtënë me armë disa herë, mirëpo, asnjëri nga ata nuk e ka vërejtur se a e ka bërë këtë në drejtim të tyre apo në ajër, pastaj, deklaratën e dëshmitarit I.B., i cili deklaroi se e ka vërejtur të akuzuarin kur e ka marrë pushkën nga vendi ku e ka lënë më parë, dhe i njëjti ka shtënë njëherë në ajër, e pastaj edhe dy herë tjera, po ashtu, në ajër dhe atë me qëllim që t'i frikësojë të dëmtuarit H.SH. dhe B.F., mirëpo, jo në drejtim të dëmtuarve, deklarata këto të cilat duke i krahasuar edhe me distancën nga ku ka shtënë i akuzuari – pra, përafërsisht prej 100 m. por edhe pozitën ku kanë qenë të dëmtuarit, që do të thotë se i akuzuari ka pasur mundësi të qëllonte në drejtim të tyre dhe t'i privojë nga jeta, atëherë, gjykata ka konstatuar se në bazë të një gjendje të tillë faktike, nuk mund të vërtetohet dashja e të akuzuarit, gjegjësisht, qëllimi i të njëjtit që t'i privojë nga jeta të dëmtuarit, për çka edhe ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentativë në veprën penale mbajtja në

pronësi, kontrolle ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari M.H., është kryerësi i veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari M.H., ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallë fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit. Po ashtu, duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, atëherë pa dyshim që në mënyrë logjike me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, se nuk mund të bëhet fjalë për vepër penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 të KPK-së, e lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK-së, për të akuzuarin V.H., të cilin e ka liruar nga akuza e prokurorisë, prandaj, edhe përkitazi me këtë të akuzuar nuk është bërë shkelje e ligjit penal, kuptohet në favor të akuzuarit, kur i njëjti është liruar nga akuza.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore – DKR në Mitrovicë, dhe ato të mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Mitrovicë, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, është dashur të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara sipas KPPK-së, e sidomos shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim më të rëndë, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit M.H., av. Q.R., përkitazi me këtë bazë ankimore, pretendon se të akuzuarit është dashur t'i shqiptohet dënim edhe më i butë dhe atë sidomos në kuptim të shqiptimit të një afati më të shkurtë verifikues se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPPK. Pretendimet e prokurorisë, nuk janë të bazuara, ngase, disa nga rrethanat rënduese të cilat ceken me ankesë, të njëjtat janë të përfshira në elementet qenësore të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, ndërsa, më tutje në ankesë vetëm në mënyrë të përgjithësuar konstaton se është dashur të merren parasysh edhe rrethanat tjera rënduese pa i cekur ato në mënyrë konkrete, ndërsa, ato të mbrojtësit të akuzuarit nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, pikërisht duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese të konstatuara dhe vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, edhe ka shqiptuar dënim të kushtëzuar dhe atë duke u bazuar edhe në faktin se vepra penale në fjalë është kryer para një kohe të gjatë, për çka edhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është zhvilluar ngjarja kritike, kontributin e veprimtarisë inkriminuese të akuzuarit, e sidomos duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kaluar nga koha e kryerjes së veprës penale-pra që nga viti 2008, e duke marrë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, faktin se që nga koha e kryerjes së veprës penale deri më sot i akuzuari nuk ka kryer vepër penale, rezulton se dënimi të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e

përgjegjesisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.396/2018, të dt. 06.10.2018

Procesmbajtësja,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

1. Xhevdet Abazi

2. Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti